



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1051/15

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtare, Lirije Maksutaj dhe sekretaren juridike, Kaltrina Citakunë konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, S.H., nga V., rr. "... M.", kundër të paditurës, Qeveria e Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, baza juridike, anulimin e njoftimit, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur më dt.26.01.2018, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

**Aprovohet**, si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.H., nga V., ndërsa **Anulohet** njoftimi i të paditurës MPMS/DAP-së, me numër të Dosjes 306 i dt. 16.03.2015.

### A r s y e t i m i

Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA –së, në mungesë të dy palëve pasi gjykata ka konstatuar se ka dëshmi në shkresat e lëndës se palët janë ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi S.H. në padinë e parashtruar me dt.24.04.2015, ka kundërshtuar në tërësi njoftimin e të paditurës, duke kërkuar që të aprovohet padia e tij si e bazuar, si dhe të detyrohet e paditura që të ja paguan këstin mujor të pensionit në shumë prej ... euro të muajit dhjetor të vitit 2014.

E autorizuar e të paditurës si në përgjigjen në padi e dhënë me shkrim me dt. 18.10.2017, ka theksuar se mbasin në tërësi si në përgjigje në padi dhe nga gjykata ka kërkuar që pas administrimit të provave të refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa aktvendimin e kontestuar me padi të lenë në fuqi si vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi që i njëjti është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi..

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor me dt.26.01.2018, ka bërë administrimin e provave dhe atë:padija e paditësit dt. 11.06.2014, njoftimi i të paditurës nr. prot 306 i dt. 16.03.2015, përgjigje në padi dt.10.08.2017, vendim dt.01.10.2009, flete aplikacion, lexohet formular, aktvendim dt.12.09.88, vërtetim dt.25.03.2008, regjistrimi i aplikimit për pension dt.06.08.2002, detaje për llogari bankare e shkresa tjera.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e njoftimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, dhe pas vlerësimit të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve në padi dhe përgjigjes të paditurës në padi dhe pas shqyrtimit të të gjithave shkresave tjera të lëndës, konstatoi se padia e paditësit është e bazuar.

Me njoftimin e goditur me padi është refuzuar ankesa e paditësit e dt. 03.03.2015, për pagesën e kistit mujor të pensionit në shumë prej ... euro të muajit dhjetor të vitit 2014, me arsyetimin se nuk është paraqitur personalisht ose përmes personit të autorizuar brenda 6 muajve në zyrat me të afërta te DP-ve.

Paditësi i pa ka kënaqur me këtë njoftim, në këtë gjykatë me padi e konteston ligjshmërinë e njoftimit të lartcekur.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton njoftimin e goditur me padi, duhet të përmbaj përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Meqenëse kjo gjykatë në konfliktin administrativ vendosë mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, në rastin konkret nga njoftimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar kjo gjendja faktike.

Kjo gjykatë konstaton se të metat e cekura si më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë në afat prej 30 ditësh të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoi të metat e lart cekura të merr aktvendim të drejtë e të bazuar në ligj.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 41 paragraf.2, 43, 46.2, 3 e lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe nenin 64 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr.1051/15, dt.26.01.2018,

Sekretare Juridike  
KaltrinaCitakuLirijeMaksutaj

G j y q t a r e,

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.